

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shteti i leshit dhe Republika e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/shteti-i-leshit-dhe-republika-e-prokuroreve-dhe-gjyqtareve-i585373
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 11:12:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 11:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b22d9871781f3a318048383f8636a0e31fc0c1f02aa20bcf8878deb086b7f6ef
TEKSTI	1a71ce533b614304c64cc81f44b32458c9b357da3ef4c205fdf590e4f6f5229d
PAMJA	f48cb27769b95322a8d6f0438e3eb31373ad4a82e125946e184ca440b67dbf9a

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	76a49301c42fbf8843fe775ab18f1d9d89565bd2f85279974f8dce6ce233b5e8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/76a49301c42fbf8843fe775ab18f1d9d89565bd2f85279974f8dce6ce233b5e8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

English

1e FMN qender për integrimin e shteteve ballkanikeLeon Musk i shpall lulte dokumentarit për jetën e tij, avokati kercënon producentet me gjyqShiste mallra të kontrabanduara - Durrës, arrestohet p
fundit

Shteti i leshit dhe Republika e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve

11 Shtator 2026, 13:50Blog TEMA



Shteti i leshit dhe Republika e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve

Ca kohë më parë, nisur nga zhvillimet në sistemin e drejtësisë për pagat, përdora një term vulgar për të përshkruar shtetin që kemi ndërtuar, shteti i leshit.

Pas zhvillimeve të ditëve të fundit, mendoj jo vetëm që kemi ndërtuar një shtet leshi, që nuk e gjen në asnjë vend europian për çudirat që prodhon, por ky shtet qenka edhe i rrezikshëm pasi një pjesë e tij i jep ultimatum pjesës tjetër të shtetit të leshit.

Së pari, dua të theksoj se e gjithë kjo zallamahi e ditëve të fundit do ishte lehtësisht e menaxhueshme, nëse nuk do kishim në krye një qeveri kaq arrogante dhe të papërgjegjshme, e cila nuk respekton Gjykatën Kushtetuese për afatet që i ka vënë për të zgjidhur çështjen e pagave të sistemit të drejtësisë.

Nëse qeveria do kishte përgatitur një propozim serioz, të mbështetur në argumenta, ta kalonte në komisionin parlamentar të ekonomisë, të bënte dëgjesa me palët e interesuara dhe të shpjegonte tërë historikun e deformimit të sistemit të pagave të drejtësisë dhe shkaqet e deformimit, sot nuk do ishim në kushtet e përplasjeve të turpshme institucionale, të cilat qartazi tregojnë se kemi shtet dhe shtetarë qesharakë. Por kjo tani nuk korregjohet.

Për qytetarin e thjeshtë duhet sqaruar se në vitin 2016, kur filloi të zbatohet reforma në drejtësi, nisur nga niveli shumë i ulët i pagave në Shqipëri (më të ultat në Europë), si dhe për t'i siguruar atyre mbrojtje financiare nga joshja prej korrupsionit, u vendos që pagat e sistemit të drejtësisë, si askund në Europë, të dalin jashtë piramidës së pagave të vendit.

Kjo do të thoshte që pranuam me vetëdije që pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve të SPAK dhe GJKKO të jenë më të mëdha se e Presidentit të Republikës kurse të prokurorëve dhe gjyqtarëve të sistemit të përgjithshëm mbi nivelin e pagave të funksioneve të larta drejtuese si p.sh. deputetëve.

Në vitin 2023, qeveria me një veprim krejt të domosdoshëm, dyfishoi pagat e administratës publike ose e thënë ndryshe, pagat e piramidës së pagave në Republikën e Shqipërisë.

Kjo u bë për t'i dhënë fund pagave qesharake që shpërndante shteti për administratën e tij, në mënyrë që ato të bëheshin të krahasueshme me vendet e rajonit.

Por oreksi vjen me të ngrënë.

Gjyqtarët dhe prokurorët kërcyen përpjetë dhe megjithëse ishin jashtë sistemit të pagave të vendit si rast përjashtimor, kërkuan që edhe pagat e tyre të dyfishoheshin.

Qeveria me të drejtë nuk e pranoi këtë kërkesë dhe ju bëri pagave të sistemit të drejtësisë një rritje modeste, e cila i linte të gjithë nivelet e pagave të sistemit të drejtësisë mbi nivelin e pagës së deputetit dhe gjithë nivelet e pagave të prokurorisë dhe gjykatës së posaçme mbi nivelin e pagës së Presidentit të Republikës.

Krahasoni sa ishin pagat e gjyqtarëve pas rritjes në vitin 2023 dhe sa kërkon sistemi i drejtësisë të jenë me vetritjen që kanë bërë:

Paga bruto e deputetit sot është 310.000 lekë kurse paga e Presidentit të Republikës 435.621 lekë.

Shikoni të ndëruar qytetarë, gjyqtarët dhe prokurorët e sistemit të përgjithshëm të drejtësisë kërkojnë të kenë pagën 1.83 herë më të madhe se deputetët dhe 1.3 herë më të madhe se të Presidentit, kurse gjyqtarët dhe prokurorët e SPAK dhe GJKKO ta kenë pagën 3 herë më të lartë se deputetët dhe 2.3 herë më të lartë se të Presidentit të Republikës.

Duke përfutur nga arroganca dhe papërgjegjshmëria e qeverisë që nuk adresoi me ligj dhe në kohë këtë problem, KLP dhe KLGJ, pa asnjë bazë ligjore morën vendim duke i vendosur pagat e sistemit të drejtësisë sipas oreksit të tyre.

Sot ata kërkojnë llogari dhe kërcënojnë që nëse nuk zbatohet vendimi që kanë marrë për pagat e tyre, ata do pezullojnë punën në gjykata.

Kërcënimet nuk vijnë vetëm nga gjyqtarët dhe prokurorët si individë, por nga e gjithë piramida e institucioneve dhe drejtuesve të sistemit të ri të drejtësisë që kemi krijuar, të cilët tregojnë mungesë të theksuar formimi dhe etike publike.

Për më tej, në një veprim skandaloz dhe absurd, gjykatësit dhe prokurorët ankohen kundër shtetit të tyre se përse nuk miraton vetritjen e pagave që ata kanë bërë.

As më shumë e as më pak por tek gjykatësit dhe prokurorët...alias tek vetja e tyre. A nuk kam të drejtë në këtë rast ta quaj shtetin shqiptar shtet lesi kurse Republikën tonë Republikë të Gjykatësve dhe Prokurorëve?

Nëse gjykatësit dhe prokurorët mbyllin gjykatat sepse pagat e tyre nuk rriten 2 deri në 3 herë mbi pagën e Presidentit, atëherë përse ne qytetarët nuk paskemi të drejtë të ngrihemi dhe protestojnë në dyert e gjykatave të pangopura të cilat kërkojnë të rrjepin taksat tona?

Përse duhet që një kastë të tillë ta mbajmë mbi qafë kur drejtësia e re qenka edhe më e pafytyrë se drejtësia e vjetër?

Një thirrje për kolegët e opozitës: ju jeni sot në opozitë por është jashtë llogjikës politike të dilni në krah të kësaj çmendurie me kosto shtesë 40 milione euro në vit vetëm e vetëm se jeni kundërshtarë të mazhorancës. Një ditë mund të jeni në mazhorancë dhe do paguani çmendurinë që po mbështesni sot.

Qytetarët e vendit po ju ndjekin dhe do t'i japin atë që meriton kujt do të përfshirë në këtë çmenduri shqiptare./[Marrë nga Facebook i Edmond Spahos](#)

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Ministrja që Rama po kërkon](#)

12:40 Blog / 1 koment

[Demokracia, jo më si vlerë lirie](#)

12:30 Blog

[Një telash më shumë për Partinë Demokratike](#)

19:10 Blog / 20 komente

[Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin](#)

18:28 Blog / 33 komente

[Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë](#)

17:05 Blog / 8 komente

[Përse do të jetë “fair” që Erion Veliaj të lirohet](#)

12:38 Blog / 20 komente

[Veliaj përballë standardit të ri të Gjykatës së Lartë: A do të zbatohet ligji njësoj për të gjithë?](#)

10:25 Blog / 24 komente

[Dinjitet nuk ka vetëm deputeti...](#)

09:42 Blog / 35 komente

[Programi i ri politik i Partisë Demokratike](#)

08:45 Blog / 1 koment

[Lista e Kryetares së Kuvendit](#)

07:57 Blog / 4 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[“Berisha gënjeu demokratët” - Bejko: Nuk ka më të drejtën...](#)

09:45 Politika / 20 komente

[Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...](#)

15:45 Politika / 29 komente

[EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej “afërën e armëve” m...](#)

15:30 Dossier / 12 komente

[Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...](#)

13:04 Politika / 51 komente

[‘Kallëzim se po zbatoj ligjin’, ministri Malaj publikon p...](#)

19:05 Politika / 77 komente

Blog Tema

[Ministria që Rama po kërkon](#)

12:40 Blog / 1 koment

[Demokracia, jo më si vlerë lirie](#)

12:30 Blog

[Një telash më shumë për Partinë Demokratike](#)

19:10 Blog / 20 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

Tema është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, Tema është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.





Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)
- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)
- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.